

(<https://top-channel.tv/>)

AKTUALITET ([HTTPS://TOP-CHANNEL.TV/ARTIKUJ/VENDI/AKTUALITET/](https://top-channel.tv/artikuj/vendi/aktualitet/))

KRYESORE ([HTTPS://TOP-CHANNEL.TV/ARTIKUJ/KRYESORE/](https://top-channel.tv/artikuj/kryesore/))

TË FUNDIT ([HTTPS://TOP-CHANNEL.TV/ARTIKUJ/TE-FUNDIT/](https://top-channel.tv/artikuj/te-fundit/))

I dënuar me 15 vite burg për vrasje, kapet 40-vjeçari i rrezikshëm në Shijak (emri)

□ 08/10/2019 08:46



(https://www.facebook.com/app_id=1715618661991455/channel.tv/2019/10/08/i-denuar-me-15-vite-burg-per-vrasje-kapet-40-vjecari-i-rrezikshem-ne-shijak/&redirect_uri=https://top-channel.tv/2019/10/08/i-denuar-me-15-vite-burg-per-vrasje-kapet-40-vjecari-i-rrezikshem-ne-shijak/) □

([whatsapp://send?](https://www.whatsapp.com/send?text=https://top-channel.tv/2019/10/08/i-denuar-me-15-vite-burg-per-vrasje-kapet-40-vjecari-i-rrezikshem-ne-shijak/)

[text=https://top-channel.tv/2019/10/08/i-denuar-me-15-vite-burg-per-vrasje-kapet-40-vjecari-i-rrezikshem-ne-shijak/](https://top-channel.tv/2019/10/08/i-denuar-me-15-vite-burg-per-vrasje-kapet-40-vjecari-i-rrezikshem-ne-shijak/)) □

(<https://twitter.com/intent/tvtext=I+d%C3%ABnuar+me+15+vite+b%26burg+per+vrasje+kapet+40+vje%C3%A7ari+i+rreziksh%C3%ABm+n%C3%A9+Shijak+%28emri%29+Top+Channel>)



Një 40-vjeçar i cili cilësohet se një person me rrezikshmëri të lartë shoqërore, i dënuar më parë me 15 vite burg për vrasje u kap nga policia në Shijak.

Për të kapur Gentian Ballën u ngritën pika kontrolli grackë dhe u bë i mundur identifikimi i automjetit me të cilin lëvizte ai..

Në momentin që Policia ka ndërhyrë për të ndaluar ndaluar automjetin, 40-vjeçari banues në Shijak ka braktisur mjetin dhe ka tentuar të largohet me vrap duke hedhur edhe armën e zjarrit në tokë, por është kapur dhe prangosur në flagrancë nga shërbimet e policisë, të cilat kishin ngritur perimetër sigurie për të mos lejuar largimin e tij.

Balla është person me rrezikshmëri të lartë, me precedent kriminal në fushën e krimeve ndaj personit dhe ka qenë i dënuar më parë me 15 vite burg për veprën penale “Vrasja me dashje”, ngjarje e ndodhur në vitin 1997.

Shijak -Finalizohet operacioni policor “Magnum 2”

Kapet një person me rrezikshmëri të lartë shoqërore, i dënuar më parë me 15 vite burg për vrasje.

Në pranga 40-vjeçari, i cili qarkullonte me armë zjarri me vete.

Sekuestrohet një armë zjarri pistoletë dhe municion luftarak.

Specialistët për Hetimin e Krimeve në Komisariatit e Policisë Shijak në bashkëpunim me Forcat Operacionale të DVP Durrës, në vijim të punës së tyre për rritjen e parametrave të sigurisë së komunitetit në bazë të informacioneve të siguruara në rrugë operative se një shtetas, i cili qarkullonte me një automjet mbante armë zjarri me vete kanë organizuar menjëherë punën duke finalizuar me sukses operacionin e koduar “Magnum 2”.

Në kuadër të operacionit, duke marrë parasysh rrezikshmërinë e personit, u ngritën pika kontrolli grackë dhe u bë i mundur identifikimi i automjetit me të cilin lëvizte personi i dyshuar.

Në momentin që Policia ka ndërhyrë për të ndaluar ndaluar automjetin, 40-vjeçari G. B., banues në Shijak ka braktisur mjetin dhe ka tentuar të largohet me vrap duke hedhur edhe armën e zjarrit në tokë, por është kapur dhe prangosur në flagrancë nga shërbimet e policisë, të cilat kishin ngritur perimetër sigurie për të mos lejuar largimin e tij.

Në përfundim të veprimeve u bë arrestimi në flagrancë për veprat penale “Mbajtja pa leje e armëve dhe municioneve luftarake” dhe “Mosbindja ndaj urdhrit të punonjësit të policisë”, si dhe u sekuestrua në cilësinë e provës materiale arma e zjarrit pistoletë, me 13 fishekë luftarakë dhe automjeti tip Benz.

Shtetasi G. B. është person me rrezikshmëri të lartë, me precedent kriminal në fushën e krimeve ndaj personit dhe ka qenë i dënuar më parë me 15 vite burg për veprën penale “Vrasja me dashje”, ngjarje e ndodhur në vitin 1997.